



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.422/18

Më  
Dana

24-05-2018

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-  
Divizioni Penal-** në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga "[REDACTED]" pa nr., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2163-2/2016 të datës 20.03.2018, për shkak të veprës penale dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2163-2/2016 të datës 20.03.2018 për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 23.04.2018 mori:

**AKTGJYKIM**

**PRANOHET** Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2163-2/2016 të datës 20.03.2018 , gjykata jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I pandehuri, [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga "[REDACTED]" pa nr., i lindur më [REDACTED] në të njejtin vend, nga babai [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] posedon numrin personal [REDACTED], ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTORE

Sepse më datën 08.09.2016 në kohë të pa caktuar në Ferizaj në Rrugën "15 Shkurti" me qëllim të pengimit të realizimit të drejtave pronësore bartjen e pasurisë të cilën të drejtë e kanë të dëmtuari [REDAKTUAR] dhe të tjerët në mënyrë të kundërligjeshme i kushtëzon me pagesë me shuma të mëdha me qëllim që të bëjnë bartjen e pronësisë në emrat e të dëmtuarve,-

**Me të cilën ka kryer veprën penale dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK-së .**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

## GJYKON

**DENIM ME GJOBË** në lartësi prej 200 euro (me shkronja dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

I dëmtuari : [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rrugë [REDAKTUAR] pa nr., për relaizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj me akuzën e vetë PP/II nr. 2163-2/16 të datës 20.03.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., , për shkak të veprës penale dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK-së, e njëjtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor PP/II nr. 2163-2/16 të datës 20.03.2018 me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar deklaratat e të pandehurit e dates 16.09.2016, deklarata e të dëmtuarve 08.09.2016 dhe e dëshmitarit 03.11.2016, të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK-së . Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshtuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së , gjykata i shqiptoi të pandehurit dënimin me gjobë, pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me dënim sipas ligjit.

Në bazë të nenit 458-460 të KPPRK-së, i dëmtuari : [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., për relaizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së, i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.


Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P nr.422/18, datë 23.04.2018**

**Zyr.ligjor**  
**Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,**  
**Elmaz Zenuni**



**Këshilla juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Ndërkaq, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nga një kopje u dërgohet PTH-së dhe të dëmtuarit.